



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 1328/1 Prot.

Tiranë, më 19.09.2022

VENDIM

Nr. 70 Date 19.09 2022

**“PËR HAPJEN E PROCESIT PËR APLIKIM TË KANDIDATËVE PËR ANËTAR  
PËR VENDIN VAKANT NË BORDIN E ADMINISTRIMIT”**

Në zbatim të neni 48 të Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL-të e Republikës së Shqipërisë”, neni 42 të Statutit të UST-së, neni 23 të Rregullores së Brendshme të UST-së, Senati Akademik në mbledhjen e datës 19.9.2022

Vendosi:

1. Fillimin e procesit për regjistrimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit për vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e përfaqësuesit të UST-së Prof.Asoc. Fisnik Brovina.
2. Kandidatët duhet të vetëkandidohen pranë Sekretarisë së Senatit Akademik.
3. Regjistrimi pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UST-së do të bëhet nga data 19.9.2022 - 23.9.2022 ora 12.00.
4. Sekretaria e Senatit Akademik të përpilojë “Njoftim” për të gjithë të interesuarit me të dhënat e sakta për kriteret, mënyrën, vendin dhe periudhën kohore të aplikimit.
5. Ngarkohen për zbatimin e këtij Vendimi, drejtuesit e Njësive Kryesore si dhe Sekretari i Senatit Akademik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK**

**Prof. Dr. AGRON KASA**

**REKTOR**

